



Prishtinë, 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_088_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 17 të Licencës Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
3. Kërkesë zyrtare të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH.A. të dërguar me date 25 mars 2008, **në seancën e mbajtur me date 24 qershor 2008, nxori këtë:**

VENDIM

I. Aprovohet Kodi i Punës për Qasje ne Tokë dhe Ndërtesa i KOSTT SH.A.

1. Në mars të vitit 2008 KOSTT-i ka ushtruar kërkesën për aprovimin e Kodi i Punës për Qasje në Toka dhe Ndërtesa.
2. ZRRE ka shqyrtuar Kodin në fjalë dhe ka bërë vlerësimin dhe plotësimin e tij.
3. Nga data e pranimit të këtij vendimi, KOSTT-i do të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të Kodi i Punës për Qasje në Tokë dhe Ndërtesa.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e aprovimit apo nga data e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Bashkangjitur: Versionet shqip dhe anglisht të Kodit të Punës për Qasje në Tokë dhe Ndërtesa për KOSTT SH.A. Në rast të mospërputhshmërisë, do të mbisundojë versioni në gjuhën angleze në të cilin është hartuar versioni origjinal i këtij Kodi.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar